



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

RAPORT VJETOR 2024



Kush Jemi

Partnerët Shqipëri është një OJF shqiptare e pavarur, e themeluar në vitin 2001, që mbështet shoqërinë civile dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndër-sektorial me qëllim forcimin e institucioneve demokratike dhe avancimin e zhvillimit ekonomik.

Partnerët Shqipëri është anëtare e Kodit të Standardeve të Organizatave Jofitimprurëse në Shqipëri, dhe luan rolin e Sekretariatit të Kodit përmes Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile.

Partnerët Shqipëri është anëtare e Partners Network, një partneritet i 19 organizatave të pavarura në Evropë, Amerikën Veriore dhe Jugore, Afrikë e Lindjen e Mesme, të cilat punojnë për një ndryshim paqësor e demokratik.

Partnerët Shqipëri është anëtare edhe e disa rrjeteve të tjera globale, rajonale dhe evropiane si BCSDN, ECAS, DIESIS, ANNA LINDH, WINGS, Alliance for Peacebuilding, CHANCE – Civil Hub Against orgaNised Crime in Europe, etj.

www.partnersalbania.org

Përmbajtja

Fjalë përshëndetëse	4-5
Fakte kryesore nga 2024	6-7
Programet tona	10-45
Shërbime me pagesë	46
Puna jonë në media	47
Projektet	48
Mbështetësit tanë kryesorë	49
Financat	50



FJALA PËRSHËNDETËSE



Juliana Hoxha
Drejtores

Është kënaqësi për mua të paraqes Raportin Vjetor 2024 të Partnerëve Shqipëri, një vit i shënuar nga rritja institucionale, mësimi i vazhdueshëm, zgjerimi i veprimtarisë dhe rezultate të prekshme.

Megjithatë, teksa shkruaj këtë mesazh në vitin 2025, bota tashmë duket ndryshe. Mjedis i ku vepron shoqëria civile ka ndryshuar ndjeshëm jo vetëm në aspektin e financimeve, por edhe për shkak të një sulmi të paprecedentë ndaj vlerave liberale dhe vetë hapësirës qytetare. Ajo që një vit më parë dukej e qëndrueshme, sot ndjehet e brishtë, ndërsa hapësirat demokratike vazhdojnë të ngushtohen dhe liritë qytetare përballen me presione të reja.

Ky realitet na ka shtyrë të reflektojmë me ndershmëri dhe vendosmëri, të rimendojmë mënyrën si punojmë, të rivlerësojmë bazën tonë mbështetëse dhe të ndërtojmë aleanca të reja, të afta t'i bëjnë ballë një konteksti gjithnjë e më kompleks. Për Partnerët Shqipëri, viti 2025 ka qenë një periudhë thellimi strategjik, për të forcuar misionin tonë në këtë "rend të ri" që tashmë duket se është këtu për të qëndruar gjatë. Ndërsa procesi i integritetit evropian të Shqipërisë përparon me ritme më të shpejta, ky mision bëhet edhe më i rëndësishëm.

Në vitin 2024, puna jonë u përqendrua në katër fusha programatike kryesore: mjedisi mundësues dhe fuqizimi i shoqërisë civile, sipërmarrja dhe inovacioni social, filantropia dhe qeverisja me pjesëmarrje.

Përmes 15 projekteve shumëvjeçare, ekipi ynë në bashkëpunim me 24 organizata në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian, si dhe me kontributin e 42 ekspertëve, ka mbështetur dhe përfshirë rreth 3,000 përfitues. Këto shifra pasqyrojnë përpjekjet e përbashkëta në ndërtimin e njohurive dhe aftësive, forcimin e aleancave, konsolidimin e ekosistemit dhe ndikimin në politikatat publike. Në thelb të punës sonë mbetet përpjekja për sisteme më të drejta dhe përforsimi i zërit të grupeve përfituese në rrugëtimin e Shqipërisë drejt integritetit evropian.

Një nga gurët e themelit të këtij misioni mbetet Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, të cilën e drejtojmë me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Qendra ka kaluar përtej funksionit të saj fillestar si qendër shërbimesh, duke u kthyer në një platformë kombëtare të besueshme që lidh organizatat, forcon qeverisjen dhe siguron që shoqëria civile të mbetet një partnere kyçe në reformat demokratike dhe procesin e integritetit në BE.

Nëpërmjet zyrave të saj në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë, dhe në bashkëpunim të ngushtë me partnerë në nivel kombëtar e rajonal, Qendra ka ndërtuar dije, ka zgjeruar pjesëmarrjen dhe ka forcuar zërin qytetar në politikëbërje. Puna e saj në fushat e qeverisjes, vullnetarizmit, transparencës dhe llogaridhënies ka mbështetur rreth 1300 individë dhe organizata për të rritur kapacitetet, bashkëpunimin dhe besueshmërinë e tyre.

Ne kemi vijuar të forcojmë mjedisin mundësues për shoqërinë civile, duke kontribuar në reforma që e bëjnë sektorin më transparent dhe të qëndrueshëm. Përmes advokimit tonë mbi ndryshimet në rregulloren e TVSH-së, u arrit heqja e pengesave fiskale për organizatat jofitimprurëse, duke përmirësuar qëndrueshmërinë e tyre financiare dhe kapacitetet për zbatimin e projekteve. Gjithashtu, pjesëmarrja në Agjendën Kombëtare të Reformave 2024–2027 dhe në procesin për Ligjin për Vullnetarizmin, mundësoi informimin dhe mobilizimin e sektorit duke siguruar që zëri i shoqërisë civile të dëgjohet në proceset e politikëbërjes.

Inovacioni ka mbetur një nga angazhimet tona më të forta. Përmes Challenge Fund, pjesë e programit EU4I, 39 startup-e përfituan rreth 700,000 euro financim dhe asistencë teknike për të nxitur inovacionin në biznese e shërbime dhe për të hyrë në tregjet vendore dhe evropiane. Ne jemi krenarë që Challenge Fund ka arritur të mbështesë sipërmarrës nga i gjithë vendi, si dhe që 50% e startup-eve të mbështetura drejtohen nga gra.

Nisma TWIST vijoi të transformojë asetet e konfiskuara në hapësira krijuese për komunitetin, ndërsa projekti i ri për riciklimin e qelqit, në kuadër të Lab of Tomorrow, tregoi se si zgjidhjet lokale mund të sjellin qëndrueshmëri dhe vlerë sociale. Këto ndërhyrje po ndihmojnë në krijimin e një ekosistemi më dinamik të startup-eve dhe në afrim të mëtejshëm me standardet e Bashkimit Evropian.

Në fushën e filantropisë, vërehet një rritje e ndjeshme e frymës së dhurimit qytetar me një rritje mbi 3% të donacioneve krahasuar me vitin paraardhës. Aktiviteti i 6-të "Rrathë Dhurues" mobilizoi 2.2 milionë lekë nga individë dhe biznese për projekte në arsim, përfshirje dhe mjedis. Këto iniciativa jo vetëm që adresuan mungesa në komunitetet e nënpërfaqësuar, por edhe mundësuan programe pilot që më pas tërhoqën mbështetje institucionale për zgjerim në shkallë kombëtare. Ndërkohë, monitorimi ynë i vazhdueshëm mbi filantropinë po rrit transparencën dhe besimin në kulturën e dhurimit, duke dëshmuar se bujaria nuk është vetëm një akt personal, por edhe një forcë publike për të mirën e përbashkët.

Në qeverisjen me pjesëmarrje dhe llogaridhënëse, kemi thelluar angazhimin tonë përmes kërkimeve, trajnimeve dhe advokimit, duke forcuar pjesëmarrjen qytetare dhe transparencën institucionale. Kemi kontribuar në konsultimet për Ligjin për Rininë, Strategjinë për Zhvillimin e Sipërmarrjes Inovative 2024–2030, si dhe në kornizat antikorupsion në përputhje me standardet e BE-së. Angazhimi ynë në proceset e konsultimit për të Drejtat Themelore ka qenë i qëndrueshëm, me komente e analiza të rregullta për Raportin e Vëdit për Shqipërinë, Raportin për Shtetin e së Drejtës dhe dokumentet përkatëse të monitorimit.

Partneritetet tona rajonale dhe evropiane kanë vazhduar të lidhin shoqërinë civile shqiptare me agjendat më të gjera evropiane dhe globale. Ndërsa Shqipëria i afrohet gjithnjë e më shumë Bashkimit Evropian, angazhimi ynë është të sigurojmë që shoqëria civile të mos jetë vetëm pjesë e procesit, por edhe një forcë udhëheqëse që ndikon në cilësinë e demokracisë dhe qeverisjes që ajo përfaqëson. Këtë e pasqyron edhe angazhimi ynë i shtuar në dialogun kombëtar e rajonal me institucionet e BE-së gjatë vitit 2024.

Ne do të vazhdojmë të bëjmë atë që dimë më mirë: të lidhim njerëzit, të ndërtojmë dije, të flasim me ndershmëri dhe të shtyjmë përpara ndryshime që kanë ndikim real. Asgjë nga këto nuk arrihet vetëm. Ndaj mirënjohja ime më e thellë shkon për ekipin tonë, partnerët, donatorët dhe çdo qytetar që beson se bashkëpunimi dhe integriteti janë ende forca që mund ta çojnë shoqërinë përpara.



FAKTE NGA PUNA JONË NË 2024

Aktivitetet dhe pjesëmarrësit

410
DITË VEPRIMTARI



316
AKTIVITETE

- ▶ Trajnime
- ▶ Mentorime
- ▶ Sesione Informuese
- ▶ Evente rrjetëzimi
- ▶ Konferenca ndërkombëtare & evente publike
- ▶ Konkurse / Pitching event
- ▶ Evente dhurimi Live
- ▶ Tryeza diskutimi
- ▶ Vizita studimore

2858
PJESËMARRËS TË DREJTPËRDREJTË


Pjesëmarrja sipas gjinisë



F 63%
M 37%

42
LEKTORË & EKSPERTË
TË ANGAZHUAR

Projektet dhe partnerët



15
PROJEKTE

8
DONATORË

24
PARTNERË ZBATUES

Ndjekësit dhe angazhimi në rrjetet sociale



33K
Ndjekës
2.5 K më shumë në vitin 2024

78K
Vizita
12 K më shumë në vitin 2024

506K
Audienca e arritur
6 K më shumë në vitin 2024

237%
Më shumë angazhim në përmbajtje krahasuar me 2023

Publikimet dhe daljet në media

30
PUBLIKIME

Studime
Raporte
Revista
Broshura
Buletine informative



50+
ARTIKUJ E DALJE
NË MEDIA



Përfaqësimi



- ▶ Kombëtar
- ▶ Rajonal
- ▶ Global



Rrjeti "Partners"
Alliance for
Peace-building



Rrjeti DIESIS
Rrjeti ECAS



Rrjeti Ballkanik për
Zhvillimin e Shoqërisë
Civile



Rrjeti WINGS



Rrjeti
ANNA LINDH



CHANCE - Civil Hub
Against organised Crime
in Europe



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

FUSHAT TONA PROGRAMATIKE

- ▶ Mjedi mundësues dhe zhvillimi i qëndrueshëm i shoqërisë civile
- ▶ Sipërmarrja dhe Inovacioni Social
- ▶ Aktiviteti filantropik dhe infrastruktura mbështetëse
- ▶ Qeverisja me pjesëmarrje transparente dhe e përgjegjshme

ÇFARË OFROJMË

- ▶ Ndërtim dhe fuqizim kapacitetesh
- ▶ Mbështetje financiare
- ▶ Advokim dhe punë kërkimore

PËRFITUESIT TANË

- ▶ Shoqëria civile
- ▶ Sipërmarrësit socialë dhe novatorë
- ▶ Institucionet shtetërore dhe politikë-bërësit



FUQIZIMI I KAPACITETEVE TË SHOQËRISË CIVILE





— Ndërtim Kapacitetesh

7 PROGRAME

- ▶ Akademia e OJF-ve
- ▶ Dizajnimi dhe Manaxhimi i Skemave të Nën-grantimit
- ▶ Gjenerimi i të Ardhurave, Ngritja e Fondeve përmes Shërbimeve me Pagesë
- ▶ Shkëmbimi i OJF-ve
- ▶ Adaptueshmëria Organizative (Resiliency +)
- ▶ EU Aquis - Angazhimi dhe Roli i OSHC-ve në Procesin e Integrimit të Vendit në BE
- ▶ Programe Trajnimi Sipas Nevojave

Temat

- Adaptueshmëria organizative (Resiliency +)
- Advokasia dhe lobimi
- Anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe roli i OJF-ve në këtë proces
- Gjenerimi i të Ardhurave, Ngritja e Fondeve përmes Shërbimeve me Pagesë
- Komunikimi strategjik i OJF-ve
- Kuadri ligjor për sektorin e OJF-ve në Shqipëri
- Dizajnimi dhe Manaxhimi i Skemave të Nën-grantimit
- Manaxhimi financiar- buxheti dhe kontabiliteti, detyrimet dhe raportimet në shtet
- Mobilizimi i mbështetësve, krijimi i rrjeteve dhe koalicionëve
- Ndërtimi i partneriteteve për projekte të qëndrueshme në kuadër të programit European Solidarity Corps (ESC)
- Sigurimi i mbështetjes nga grantet, fondet publike, filantropia dhe puna me sektorin privat
- Planifikimi strategjik
- Qeverisja me pjesëmarrje
- Platformat dhe fushatat e financimit kolektiv (Crowdfunding)
- Hartimi i projekt-propozimeve dhe manaxhimi i projekteve të mbështetura nga fondet e BE-së
- Zhvillimi dhe qeverisja organizative, manaxhimi i burimeve njerëzore dhe procedurat e brendshme

37 DITË TRAINIMI

253 SEANCA MENTORIMI

3 PROGRAME VIZITASH STUDIMORE

445 PËRFITUES

Pjesëmarrja sipas gjinisë



Përfitues jashtë kryeqytetit



— Shërbime mbështetëse, informim dhe rrjetëzim, asistencë për rrjetet

487 KËRKESA PËR INFORMACION
NGA OJF-TË, TË ADRESUARA

141 Organizata dhe aktivistë të asistuar

27 SESIONE INFORMUESE
RAJONALE

603 Pjesëmarrës - OJF, aktivistë dhe mbështetës

2 EVENTE KOMBËTARE
RRJETËZIMI

141 Pjesëmarrës

4 RRJETE TË ASISTUARA

4 Nisma advokuese të ndërrmarra



DËSHMI TË PËRFITUESVE TANË

Programi i Shkëmbimit të OJF-ve

“

Pjesëmarrja në Programin e Shkëmbimit të OJF-ve ishte një eksperiencë e frytshme profesionale. Patëm mundësi të njohim nga afër funksionimin dhe organizimin e disa institucioneve publike, nga ku mësuam mekanizma të rinj për pjesëmarrje në procese politikëbërëse. Nga ana tjetër, po aq frymëzues ishte shkëmbimi i eksperiencave dhe njohja me kolegë të rinj nga organizata të shoqërisë civile. Vlerësoj pa fund krahas të tjerave, punën e organizatave në fushën e shërbimeve si Qendra e Kujdesit Paliativ “Mary Potter” në Korçë dhe Qendra “Jonathan” në Tiranë. Falënderues ndaj Partnerët Shqipëri për mundësinë dhe e rekomandoj këtë program për organizatat e tjera në vend. Faleminderit!

Pajtim Nikolli

Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS)

“

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të thellë për mundësinë që Partnerët Shqipëri më ofruan për t’u bërë pjesë e programit të shkëmbimit. Ky program ishte shumë i vlefshëm për mua, duke më ofruar njohuri të reja, mundësi për të ndërtuar rrjete dhe partneritete të reja, si dhe mundësi për të zgjeruar horizontet e mia profesionale. Pa asnjë dyshim, do ta rekomandoja këtë program për çdo person që kërkon rritje personale dhe profesionale, për shkak të strukturës së mirëorganizuar, përkushtimit të ekipit dhe përfitimeve të shumta që ofron.

Rea Balliu

Fondacioni “Diakonia Albania”






ADVOKIM DHE PUNË KËRKIMORE PËR NJË MJEDIS MUNDËSUES PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE



Analizë dhe rekomandime për projektligjin "Për Vullnetarizmin".



Analizë dhe rekomandime për zbatimin e Udhëzimit Nr. 27, datë 13.9.2023 Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Udhëzimin Nr.6, datë 30.1.2015, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".



Raporti për Shqipërinë "Nga heshtja në fuqi: Një përgjigje rajonale ndaj SLAPP-eve (Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike) në Ballkanin Perëndimor", pjesë e një raporti rajonal.



Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë 2023





Analizë dhe rekomandime mbi dokumentin e politikave "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024 - 2027".



Raporti i "Vlerësimit të kapaciteteve dhe nevojave të OSHC-ve në Shqipëri" për vitin 2024



Analizë e ndryshimeve në Rekomandimin 8 dhe Dokumentit të Praktikave më të Mira të FATF gjatë vitit 2023.



Dëftesat mbi Progresin dhe Nivelin e Përgatitjes së Shqipërisë drejt Anëtarësimit në Bashkimin Evropian

- Vlerësimi i Kapitullit 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore)
- Vlerësimi i Kapitullit 24 (Drejtësia, Liria, Siguria)
- Vlerësimi i Kriterit Politik

Kontribut në agjendën rajonale lidhur me mjedisin mundësues për shoqërinë civile




Strategji e re për Mbrojtjen dhe Zgjerimin e Hapësirës Civile në Ballkan 2024-2027, diskutuar në takimin e 18-të vjetor të Këshillit të BCSDN, mbajtur më 20 mars në Vjenë, Austri.



Workshop Rajonal "Joint Action Against SLAPPs in the Western Balkans", mbajtur në Tiranë më 28-29 maj, me fokus adresimin e kërcënimit që paraqesin Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP) ndaj lirisë së shprehjes dhe pjesëmarrjes publike në rajon.



Deklaratë e përbashkët e rrjetit BCSDN dhe organizatave të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë për vazhdimin dhe zgjerimin e nismës së EESC duke përfshirë në të edhe Kosovën.



Deklaratë e përbashkët e pjesëmarrësve në Forumin e Shoqërisë Civile të BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, organizuar nga TACSO, që thekson rëndësinë e proceseve transparente dhe gjithëpërfshirëse në zbatimin e Planit të Ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, duke nënvizuar rolin kritik të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve socialë në hartimin e Agjendave të Reformës.



Analizë dhe rekomandime mbi paketën e re të BE-së për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit, e cila ndikon ndjeshëm në sektorin jofitimprurës, veçanërisht platformat e financimit kolektiv (crowdfunding), transfertat ndërkufitare dhe donacionet në monedha virtuale.



Shoqata Shqiptare e ish-pjesëmarrësve në programet e shkëmbimit në Shtetet e Bashkuara (AUSA) festoi një moment historik me ceremoninë e parë të ndarjes së çmimeve, duke njohur kontributet e jashtëzakonshme të 2,000 të diplomuarve në fusha të ndryshme.

Znj. Juliana Hoxha, Drejtore e Partnerët Shqipëri u vlerësua me Çmimin për Demokracinë nën motivacionin "Ky çmim synon të nderojë individët të cilët kanë demonstruar kurajo të jashtëzakonshme dhe kreativitet në nismat e tyre për të avancuar kauzën e demokracisë në Shqipëri".

Ky çmim është gjithashtu një vlerësim për përpjekjen kolektive së bashku me partnerët dhe mbështetësit tanë për një qeverisje më transparente, pjesëmarrëse dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve të saj.





Përmes Challenge Fund, për të dytin vit radhazi, mbështetëm organizimin e Javës Ndërkombëtare të Sipërmarrjes në Shqipëri (GEW Albania 2024), e cila këtë vit nën sloganin “Në sipërmarrje ka vend për të gjithë” solli një larmishmëri aktivitesh nga aktorë të ndryshëm të ekosistemit. Ceremonia e shpalljes së fituesve të Thirrjes së Dytë të Challenge Fund ishte pjesë e aktiviteteve të GEW Albania 2024.



GLOBAL
ENTREPRENEURSHIP
WEEK
ALBANIA

FUQIZIMI I KAPACITETEVE TË SIPËRMARRËSVE SOCIALË DHE NOVATORË

— Ndërtim Kapacitetesh

3 PROGRAME INKUBIMI

- ▶ Programi i bizneseve të gjelbërta
- ▶ Challenge Fund EU4Innovation
- ▶ Menaxhimi i mbetjeve të qelqit

7 DITË TRAINIMI

10 DITË MENTORIM

1 VIZITË SHKËMBIMI

86 PËRFITUES

Pjesëmarrja sipas gjinisë

F 59%
M 41%

Përfitues jashtë
kryeqytetit

45%

— Informim dhe Rrjetëzim

17 SESIONE INFORMUESE RAJONALE

325 Sipërmarrës, startupe dhe individë me ide
biznesi të informuar rreth Konkursit të Ideve
të Gjelbërta dhe Thirrjeve për Propozime të
Challenge Fund

1 PANAIR

15 Sipërmarrje të mbështetura nga Partnerët
Shqipëri përmes Challenge Fund, u promovuan
në Panairin Ndërkombëtar të Tiranës

1 EVENT RRJETËZIMI

63 Sipërmarrës dhe aktorë mbështetës të
ekosistemit

Qendra "Art dhe Aktivizëm", një sipërmarrje sociale e ngritur në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar dhe korrupsioni i zyrtarëve të lartë. E mbështetur përmes projektit "TWIST- Drejt një modeli të ri të sipërmarrjes sociale në asetet e konfiskuara në Shqipëri", qendra ofron një hapësirë për artistët e rinj nga qyteti i Durrësit, duke i mbështetur për të zhvilluar dhe promovuar talentin e tyre si një mundësi drejt integritetit dhe punësimit.

PËR NJË TREG PUNE NË DOBI TË RINISË SHQIPTARE

I zbatuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation dhe Partnerët Shqipëri, dhe i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), RisiAlbania arriti ndikim të rëndësishëm në vitin 2024 në fushat e saj kryesore të ndërhyrjes: ► **zhvillimin e sektorit privat** ► **ndërmjetësimin në tregun e punës** ► **zhvillimin e aftësive** duke kontribuar ndjeshëm në punësimin e të rinjve dhe rritjen gjithëpërfshirëse ekonomike në Shqipëri.

Në **agrobiznes**, projekti mundësoi krijimin e **96** vendeve të reja pune, me një fokus të veçantë tek gratë dhe grupet e marginalizuara. Ndërmjet mbështetjes për certifikimet GlobalG.A.P., GRASP dhe SMETA, mbi **20** eksportues përfaqësojnë tani gjysmën e vlerës së eksporteve të perimeve nga Shqipëria. Kjo solli rritje të të ardhurave për fermerët, përmirësim të gjurmueshmërisë dhe qasje më të fortë në tregjet me vlerë të lartë në BE. Krijimi i një Përmbledhjeje të Bimëve Mjekësore dhe Aromatike (MAPs) dhe partneritetet institucionale, si p.sh. Marrëveshja e Mirëkuptimit mes Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe shoqatave të MAPs, institucionalizuan më tej rritjen e sektorit dhe transferimin e njohurive.

Ndërhyrjet në **turizëm** rezultuan në **219** vende të reja pune afatgjata, teksa bizneset miratuan praktika të qëndrueshme dhe certifikime si GSTC dhe Travelife. Operatorët turistikë dhe NVM-të vendore në turizëm investuan mbi **380,000 €**, duke gjeneruar mbi **300,000 €** të ardhura neto shtesë. Strategjitë kombëtare u ndikuan përmes advokimit të Risi, duke përfshirë njohjen e modelit Albergo Diffuso dhe anëtarësimin e MoTE në Këshillin Global për Turizëm të Qëndrueshëm.

Në **sektorin e TIK**, u krijuan **103** vende të reja pune përmes inovacionit në siguri kibernetike, tregti elektronike dhe shërbime digjitale. Kompanitë u zgjeruan në tregje ndërkombëtare, duke arritur fitime të konsiderueshme. Trajnimi në siguri kibernetike përfshiu gati **400** individë, ndërsa reformat në autoritetin kombëtar të sigurisë kibernetike (NACS) dhe mbështetja për certifikimin ISO ngritën më tej ekonominë digjitale të Shqipërisë.

RisiAlbania forcoi gjithashtu **ndërmjetësimin në tregun e punës**. Më shumë se **5,400** të rinj patën akses në shërbime të përmirësuara për orientim në karrierë, me **669** punësime të regjistruara, përfshirë **349** të atribuara drejtpërdrejt Risi-së. NAES, ndërmjetësit privatë dhe qendrat e karrierës në universitete ishin aktorë kyç, ndërsa shërbimet e karrierës u zgjeruan edhe në bashkitë Berat dhe Elbasan. Vlerësimi i kënaqësisë me shërbimet e karrierës varioi nga **71%** deri në **92%**.

Në **zhvillimin e aftësive**, **719** të rinj (**51%** gra, **33%** të marginalizuar) u regjistruan në trajnimet jo-formale në TIK, turizëm dhe zeje. Nga ata që përfunduan trajnimin, **653** u punësuan brenda gjashtë muajve. Krijimi i Komiteteve Sektoriale të Aftësive në TIK dhe turizëm, së bashku me përafrimin e kualifikimeve të trajnimit me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, shënoi përmirësime sistematike të rëndësishme. Një fushatë kombëtare për të nxitur të mësuarit gjatë gjithë jetës arriti mbi **23,000** përdorues, duke demonstruar angazhim të fortë me përpjekjet për përmirësim të aftësive.

Në përgjithësi, qasja sistematike e RisiAlbania vazhdon të nxisë përmirësime të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në tregun e punës, duke siguruar ndikim afatgjatë përtej ciklit jetësor të projektit.





4 SKEMA MBËSHTETJEJE ME GRANTE

Challenge Fund / EU4Innovation

EU4INNOVATION



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDËRYSHIM DHE ZHVILLIM

2

Thirrje për propozime të hapura gjatë 2024

39

Startupe të mbështetura

692,550 Euro

Vlera totale e kontraktuar

Konkursi i Bizneseve të Gjellbërta

Konkursi
I BIZNESEVE TË GJELBËRTA



4

Sipërmarrje të mbështetura

290,550 Euro

Vlera totale e kontraktuar

TWIST: Drejt një Modeli të Ri të Sipërmarrjes Sociale në Asetet e Konfiskuara në Shqipëri



10

Sipërmarrje të mbështetura

(2 sipërmarrje në prona të konfiskuara nga krimi i organizuar)

218,820 Euro

Vlera totale e kontraktuar

Programi i Inkubimit dhe granteve për manaxhimin e mbetjeve të qelqit si pjesë e Lab of Tomorrow

3

ekipe biznesesh do të mbështeten financiarisht në fund të programit të inkubimit që do të zgjasë 3muaj

EU 4 CIRCULAR ECONOMY AND LIVABLE CITIES



LAB OF TOMORROW



Implemented by

PARTNERS ALBANIA
FOR CHANGE AND DEVELOPMENT

Greenbot - the eco-friendly robot është një nga startupet e mbështetura përmes Thirrjes së Parë të Challenge Fund. Momente nga ceremonia e shpalljes së fituesve, 29 prill 2024.



DËSHMI TË PËRFITUESVE TANË

Konkursi
I BIZNESEVE TË GJELBËRTA



“

Pjesëmarrja ime në Konkursin Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta 2024 ka qenë një përvojë transformuese. Si herë e parë për mua, angazhimi në një konkurs të këtij niveli ishte befasues dhe arrita të fitoj një mbështetje prej 500,000 lekësh për ndërtimin e një ferme kërpudhash (Ferma e Kërpudhave “Monarch”) – një ide që ndodhej ende në fazën konceptuale.

Përtej vlerës financiare, kjo eksperiencë më dha më shumë sesa mund të mendoja: mësova rëndësinë e disiplinës, forcës së këmbënguljes dhe angazhimit për të ndjekur objektivat deri në fund.

Sot, falë kësaj eksperience dhe mbështetjes së marrë, kam arritur të ndërtoj një fermë kërpudhash nga zero – një projekt që mishëron pasionin tim për produktin e sigurt, të pastër dhe për një zhvillim të qëndrueshëm që i shërben komunitetit.

Rexhina Gjolla

Ferma e Kërpudhave “Monarch”



Pamje nga mjediset e **Fermës Monarch**, një nga bizneset e mbështetura përmes Konkursit të Bizneseve të Gjelbërta 2024



ADVOKIM DHE PUNË KËRKIMORE RRETH SIPËRMARRJES DHE INOVACIONIT SOCIAL



"Në sipërmarrje ka vend për të gjithë: Rugëtimi drejt sipërmarrjes sociale", aktivitet kombëtar për të evidentuar rolin e sipërmarrjes sociale si një sektor që mbështet dhe integron grupet e pafavorizuara. Eventu u organizua më 19 nëntor si pjesë e Javës Ndërkombëtare të Sipërmarrjes 2024 (GEW24).



ADVOKIM DHE PUNË KËRKIMORE RRETH SIPËRMARRJES DHE INOVACIONIT SOCIAL



Analizë dhe rekomandime të dërguara si pjesë e procesit të konsultimit të Projekt-Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024-2030 dhe të Planit të saj të Veprimit.



Ripërdorimi Social i Aseteve të Konfiskuara nga Krimi i Organizuar dhe Korrupsioni, nga OSHC-të, me Fokus në Rolin e Shtuar të Qeverisjes Vendore, një analizë ligjore dhe rekomandime mbi ripërdorimin social të asetëve të konfiskuara.



"Ekonomia Sociale në Ballkanin Perëndimor", dokument politikash i kontraktuar nga OSBE.



Broshurë e Sipërmarrjeve sociale të ngritura dhe mbështetura përgjatë viteve përmes Konkursit Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta në Shqipëri, si dhe impakti i tyre në punësim dhe ekonomi.



Seri diskutimesh me zyrtarë të lartë të institucioneve qendrore e vendore, donatorë, OSHC dhe sipërmarrje sociale në vend, në mbështetje të institucionalizimit të rolit të bashkive në ripërdorimin social të asetëve të konfiskuara.



"Në sipërmarrje ka vend për të gjithë: Rugëtimi drejt sipërmarrjes sociale", event i fokusuar në evidentimin e rolit të sipërmarrjes sociale si një sektor që mbështet dhe integron grupet e pafavorizuara, organizuar më 19 nëntor si pjesë e Javës Ndërkombëtare të Sipërmarrjes 2024 (GEW24).

Kontribut në agjendën rajonale lidhur me sipërmarrjen sociale



Eksperienca e Partnerëve Shqipëri në ripërdorimin social të pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar dhe korrupsioni i zyrtarëve të lartë, pjesë e diskutimeve në sesionin e Komitetit të OSBE-së për Çështjet Ekonomike dhe Mjedisore kushtuar "Sfidave dhe mundësive në luftën kundër korrupsionit dhe nxitjen e rikuperimit të asetëve, duke përfshirë përdorimin efektiv të mjeteve dixhitale".



"Unlocking Innovation: Western Balkans in Focus", takimi i dytë teknik, i mbajtur më 13-14 maj në Gjenevë, me fokus potencialin e jashtëzakonshëm të Ballkanit Perëndimor në ekonominë globale të shërbimeve, me theks të veçantë në nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit në industrinë e Business Process Outsourcing (BPO).



Puna e Partnerët Shqipëri në ripërdorimin social të pronave të konfiskuara nga krimi, pjesë e aktiviteteve të zhvilluara në ditën kombëtare të kujtimit të viktimave të afias në Itali, organizuar nga Libera Contro le Mafie.



Konferenca përmbyllëse e projektit WISEs4Youth, mbajtur më 19 mars në Bruksel, e cila diskutoi politikën e BE-së për sipërmarrjet sociale të të rinjve dhe nismat rajonale për ekonominë sociale, si dhe prezantoi rezultatet e projektit.

Dhurimet sipas formës


Tre format kryesore të mbledhjes së dhurimeve janë përmes **Eventeve**, **Fushatave** dhe në formë të **Drejtëpërdrejtë**.

140 dhurime në formë të Drejtëpërdrejtë

225 dhurime përmes Eventeve


107,058 dhurime përmes Fushatave

Vlera e dhurimeve sipas formës



Qëllimi i dhurimit

- Shëndetësi
- Aktivitete humanitare me bazë fetare
- Mbështetje e grupeve të marginalizuara
- Zbutja e varfërisë
- Tjetër



Fushata për ngritjen e fondeve

446
Thirrje për Dhurime

58
Fushata përmes
platformave Crowdfunding

10
Fushata përmes platformës
Facebook për Impaktin Social*

150
Fushata përmes Medias Sociale
& Platformave Crowdfunding

21
Megafushata

Shpërndarja Gjeografike e Përfituesve

98.91% e dhurimeve u
shpërndanë në Shqipëri



986
artikuj në media që shërbejnë si burim
informacioni në lidhje me rastet e dhurimeve

*hapësirë e dedikuar
për FILANTROPINË*



Rrathë Dhures është një event i cili mbledh së bashku me një qëllim filantropik, individë nga fusha të ndryshme të cilët vënë në dispozicion ekspertizën, kohën dhe burimet financiare për të mbështetur kauza konkrete që sjellin ndryshime sociale në komunitete të caktuara. Që prej vitit 2018, Partnerët Shqipëri ka organizuar disa evente "Rrathë Dhures" falë të cilave është mundur mbështetja e nismave komunitare në fushën e edukimit, promovimit të të drejtave të njeriut, aktivizmit rinor, mjedisit dhe turizmit, shërbimeve psiko-sociale për fëmijët në nevojë, përmirësimit dhe krijimit të hapësirave publike për moshën e tretë, etj.

1 "RRATHË DHURUES 2024"
edicioni i 6-të

3 NISMA TË MBËSHTETURA
NË 2024

45 DHURUES (individë dhe entitete)

2,248,340 KONTRIBUT I DHURUAR*

- ▶ ArtLab - Laboratori i Qeramikës dhe Pocerisë
Organizata zbatuese: "Përtej Barrierave", Tiranë
- ▶ "Këndi miqësor"
Organizata zbatuese: "LUNAH-Qendër Edukimi", Durrës
- ▶ "Harmonia e Fëmijërisë"
Organizata zbatuese: Qendra "Opportunity, Balance and Overcoming"- Rrëshen

* Vlera në Lekë i referohet kontributeve monetare, materiale dhe konsulencës falas të ofruar gjatë eventit



Art-Lab

Laboratori i Poçerisë & Qeramikës

Kjo nismë u realizua falë dhurimeve të individëve, OJF-ve dhe bizneseve përmes eventit "Rrathë Dhurues"

CREDINS
Foundati

CREDINS
BA

MA

R

Inaugurimi i ART LAB, ngritur në ambientet e Institutit Publik të Nxënësve që nuk Dëgjojnë në Tiranë, një laborator qeramike dhe poçerie, ku nxënësit do të marrin trajnime profesionale për të zhvilluar talentet dhe aftësitë e tyre. Mundësuar falë mbështetjes bujare të individëve dhe bizneseve në eventin Rrathë Dhurues 2024.



ADVOKIM DHE PUNË KËRKIMORE RRETH AKTIVITETIT FILANTROPIK DHE INFRASTRUKTURËS MBËSHTETËSE



Nga ekspozita me piktura të të rinjve lidhur me filantropinë, organizuar gjatë Javës së Filantropisë 2024.



Kuadri ligjor dhe rregullator për aktivitetin filantropik në Shqipëri ofron një analizë të kuadrit ligjor dhe institucional mbi metodat e ngritjes së fondeve lidhur me aktivitetin filantropik, i cili kontribuon në veprimtarinë dhe qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse në Shqipëri.



"Philanthropy" është një revistë e cila pasqyron çështje të ndryshme rreth nismave dhe zhvillimeve të aktivitetit filantropik në Shqipëri.



Partnerët Shqipëri kryen monitorimin e përditshëm të aktivitetit filantropik në Shqipëri, dhe prezanton gjetjet përmes raporteve përmbledhëse për të ndihmuar publikun e interesuar në kuptimin dhe evidentimin e këtij aktiviteti.



Java e Filantropisë 2024, një seri eventesh për promovimin e aktivitetit filantropik si leksione të hapura me studentë të Fakultetit të Ekonomisë dhe Universitetit Evropian të Tiranës, ndarja e fakteve dhe trendet e zhvillimit të aktivitetit filantropik ndër vite, inaugurimi i klasës burimore për fëmijët me aftësi të veçanta në Bulqizë - iniciativë e mbështetur përmes eventit Rrathë Dhurues, dëshmi nga dhurues kryesorë të identifikuar përmes monitorimit të aktivitetit filantropik, si dhe një ekspozitë me piktura të të rinjve lidhur me këtë tematikë.



ADVOKIM DHE PUNË KËRKIMORE PËR NJË QEVERISJE TRANSPARENTË DHE TË PËRGJEGJSHME



PJESËMARRJA
SOCIALE
E TË RINJVE
NË SHQIPËRI

PJESËMARRJA POLITIKE, SOCIALE, EKONOMIKE E TË RINJVE
Forum Diskutimi 17 Dhjetor 2024

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDËRYSHIM DHE ZHVILLIM

PJESËMARRJA POLITIKE, SOCIALE, EKONOMIKE E TË RINJVE
Forum Diskutimi 17 Dhjetor 2024

PJESËMARRJA

Forumi kombëtar "Pjesëmarrja politike, Sociale dhe Ekonomike e të Rinjve" me pjesëmarrjen e 140 përfaqësuesve të institucioneve publike, komunitetit donator, organizatave rinore, akademisë, medias dhe të rinjve nga universitete, shkolla të mesme të përgjithshme dhe profesionale. Në event u ndanë gjetjet e Raportit Kombëtar me të njëjtin titull për vitin 2023. Tiranë, 17 Dhjetor 2024.



Raporti i Monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve 2023



Indeksi i Pjesëmarrjes Rinore – Raporti Rajonal i Monitorimit mbi Pjesëmarrjen Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve 2023


Kontribut në agjendën rajonale rreth çështjeve të qeverisjes transparente



Konferenca përmbyllëse e projektit “Ballkani Perëndimor dhe Turqia për Punësimin Rinor”, zhvilluar në Beograd më 21-22 shkurt, me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të përfshirë nga rajoni, për të ndërtuar ura bashkëpunimi dhe shkëmbyer praktika të mira në drejtim të përfshirjes dhe punësimit të të rinjve.



Analizë dhe Rekomandime të dërguara për procesin e konsultimit të Projektligjit “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr.75/2019, “Për Rininë”.



Kontribut për rishikimin e dytë të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit me fokus në Kapitullin II (Masat Parandaluese) dhe Kapitullin V (Rikuperimi i Aseteve).



Analizë dhe Rekomandime lidhur me “Raportin për Shqipërinë 2024” të Komisionit Evropian.



Analizë dhe Rekomandime lidhur me “Raportin mbi Shtetin e së Drejtës 2024” të Komisionit Evropian.




Forum kombëtar diskutimi “Fuqizimi i të Rinjve përmes Përfshirjes Sociale dhe Integritit në Tregun e Punës” me përfaqësues të institucioneve qeveritare, OSHC-ve, biznesit, akademisë, të rinj dhe të reja nga vendi për të ndarë dhe diskutuar praktika të mira dhe sfida të përfshirjes së të rinjve në jetën politike, ekonomike dhe sociale në vend. Janar 2024.



Seri tryezash konsultimi me drejtues të Drejtorive të Rinisë nga 61 bashkitë në vend, për të diskutuar indikatorët e Indeksit të Pjesëmarrjes Rinore, diskutime të cilat kontribuan në përgatitjen e Raportit të Përfshirjes Politike, Ekonomike e Sociale të të rinjve për vitin 2023.



Partnerët Shqipëri, pjesë e diskutimeve në Konferencën “Përmbytja e Premtimit të Sinjalizimit: Mbrojtja e të Drejtave të Qytetarëve dhe Lufta Kundër Korrupsionit”, organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, me eksperiencën e saj në hartimin e akteve nënligjore, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimin publik për zbatimin e ligjit për sinjalizuesit. Dhjetor 2024.



Më 8 Dhjetor, Ditën Kombëtare të Rinisë, Partnerët Shqipëri ndër morri një fushatë ndërgjegjëse “Përfshirja e të Rinjve Prioritet Kombëtar: Të Veprojmë tani për të Ardhmen e Tyre!”, për të theksuar rëndësinë e përfshirjes së të rinjve. Fushata përmblente mesazhe dhe fakte rreth situatës së të rinjve, të transmetuara në ekrane digjitale në vende strategjike në të gjithë Tiranën.



5 KONTRATA SHËRBIMI

39 DITË AKTIVITET  **17** TRAJNIME
22 MENTORIME


95 PËRFITUES

- Spektori privat
- Organizata ndërkombëtare
- Organizata lokale

PROJEKTI


DONATORI

Për një treg pune në dobi të rinisë shqiptare - RISI ALBANIA	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri	Bashkimi Evropian
EU4Innovation, Phase II 2022-2026	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunimin për Zhvillim (SIDA) dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
TWIST - Drejt një Modeli të Ri të Sipërmarrjes Sociale në Asetet e Konfiskuara në Shqipëri	Bashkimi Evropian përmes Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri
Fuqizimi i Shoqërisë Civile: Rritja e Adaptueshmërisë së OSHC-ve dhe Angazhimit Publik për një Demokraci të Qendrueshme	Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri
Përmirësimi i Aktivitetit Filantropik dhe Infrastrukturës Mbështetëse në Shqipëri	Rockefeller Brother Funds
Mbrojtja e Hapësirës Qytetare - Hub-i Rajonal për Zhvillimin e Shoqërisë Civile	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunimin për Zhvillim (SIDA) përmes Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile
Iniciativa "Powered by the People"	USAID, përmes Partners Global
Balkani Perëndimor dhe Turqia për Punësimin Rinor	Komisioni Evropian
Fuqizimi i Organizatave Rinore përmes Sipërmarrjes Sociale në Turizëm (EYSET)	Bashkimi Evropian, Programi Erasmus +
WISEs4Youth në Ballkanin Perëndimor	Bashkimi Evropian, Programi Erasmus +
Ekonomia Qarkulluese për Zhvillim të Qëndrueshëm Urban	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH / Komisioni Evropian
Angazhimi i Shoqërisë Civile në Proceset e Buxhetimit Publik	International Budget Partnership
Vlerësimi i Rrezikut të OJF-ve ndaj Financimit të Terrorizmit	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
Idetë e Gjelbërta të Ballkanit – Programi i Sipërmarrjes së Gjelbër të Qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor	Rockefeller Brother Funds përmes Balkan Green Foundation




U.S. EMBASSY
Tirana, Albania





Buxheti për vitin fiskal 2024

174,446,890 Lekë



- ▶ Qeveri të huaja
- ▶ Fondacione private
- ▶ Shërbime me pagesë

